



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:051008

Datë: 16.05.2023

Numri i dokumentit: 04284360

C.nr.980/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Emine Hoti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.L nga fsh...., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.L, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti: për pagesën e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit prej 1,581.27€, jashtë seancës gjyqësore, më datën 15.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkespadija e paditësit H.L nga Gjilani, dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,796.00€, në emër të kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit për 898 ditë të pranisë në punë prej datës 18.04.2017 e deri më datë 17.04.2021, si dhe shpërblimin jubilar prej 50% të një page bazë në lartësi prej 266.98€, gjithsej shuma e përgjithshme 2,062.98€, me kamatë ligjore prej 8%, në vit, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 17.04.2020, e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II.Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 134.00€, në afat prej 7 dite, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi H.L nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim av. I.L nga Gjilani, në këtë gjykatë ka ushtruar padi më datë 17.04.2020, dhe në shqyrtimin kryesor të datës 19.10.2021, ka ndryshuar padinë në kuptimin objektiv ku ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,796.00€, edhe atë në emër të kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit prej 898 ditë të pranisë në punë prej datës 18.04.2017 e deri më datë 17.04.2021, si dhe shpërblimin jubilar prej 50% të një page bazë në lartësi prej 266.98€, gjithsej shuma e përgjithshme 2,062.98€, me kamatë ligjore prej 8 %, në vit duke filluar nga

data e ushtrimit të padisë 17.04.2020 e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën pasojat e përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës në përgjegjen në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, duke theksuar se sa i përket ditëve të punës ato nuk përputhen me kalendarin e vitit shkollor të aprovuar nga Ministria e Arsimit. Poashtu ka kundërshtuar edhe faktin se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive si dhe gjykata themelore nuk ka kompetencë lëndore për ti zgjidhur këto konteste, por i njëjti është dashur që ti drejtohet gjykatës administrative ngase afatet ligjore janë afate prekluzive të pandryshueshme të cilat nuk mundën as të zgjatën e as të shkurtohen, andaj në rastin konkret kohëzgjatja e kontratës kolektive nuk mund të jetë më e gjatë se 3 vite sic parashihet në Ligjin e Punës në nenin 90 paragrafi në 4, dhe çdo tejkallim i afatit të vlefshmërisë së kontratës nuk prodhon kurrfarë efekti juridik.

Gjykata, duke u bazuar në pretendimet e paditësve dhe të paditurës të dhëna në padi dhe përgjegjëje në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga provat materiale në padi dhe përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike se paditësi ka qenë Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Liria” në Pogradje, Komuna e Gjilanit, ngase një fakt të tillë e vërteton Kontrata e Punës 621 e datës 06.11.2019, dhe Kontrata e Punës me nr.622/2015 e datës 15.11.2015, e cila vërteton se i njëjti ka qenë ushtrues detyre në të njëjtën shkollë, dhe se ka mbi 16 vite përvojë të punës. Poashtu nuk është kontestuese fakti se paditësi ka pagën neto prej 533.96€ dhe bruto 598.55€, kurse nga vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U “Liria” në Pogradje, Komuna e Gjilanit, me nr të protokollit 21/2020, më datë 20.20.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka përvojë të punës 16 vite, kurse nga vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U “Liria” në Pogradje, Komuna e Gjilanit, me numër të protokollit 99-2021, më datë 18.10.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka 898 ditë pune, nga lista e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me nr.EM00057054, të vitit 2020, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti merr pagë mujore në lartësi prej 533.96 Euro: nga formulari për kompenzimin e punëtorit për shujta ditore dhe pagë jubilarë me numër 05-610/01-00026129/20 e datës 06.03.2020, drejtuar Komunës së Gjilanit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me kërkesë ju ka drejtuar të paditurës, por e njëjta fare nuk iu është përgjigjur, poashtu edhe në Kontratën Kolektive të Arsimit me nr.24 e datës 18.04.2017/ në nenet përkatëse në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “Punëtorët (antarë të SBASHK-ut), në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës shpërblimin 50 % të një page bazë, për 20 vite të

përvojës së punës shpërblimin 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, kurse në bazë të nenit 35 parag.7 të Kontratës, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “ *Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimi të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2(dy)€, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore* “ Gjykata konstaton se edhe me Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, në nenin 35 janë përcaktuar të njëjtat kushte dhe detyrime për të paditurën e ka rregulluar këtë materie, pasi që në nenin përkatës shprehimisht janë përcaktuar të njëjtat kushte dhe detyrime për të paditurën.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se kemi parashkrim të kërkesave gjykata ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, ka hyr në fuqi më datë 18.04.2017, kurse paditësi kërkesën e ka ushtruar tek e paditura më datë 06.03.2020, fakt që e konfirmon vet formulari i ankesës apo kërkesës, kurse padinë e ka ushtruar më datë 17.04.2020, qka do të thotë se të drejtën e tij e ka ushtruar brenda afatit prej 3 vitesh, pra brenda afatit trevjeçar, andaj nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave konform nenit 87 të Ligjit të Punës/ *Ligji nr. 03/7-212 / i cili është aktualisht në fuqi dhe i cili ka dispozitë prekluzive lidhur me kërkesat në para duke theksuar se: “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ *Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012/*, ku shprehimisht është përcaktuar se „ *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 30.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 134.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:051008, 16.05.2023

Gjyqtari,
Berat Spahi

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.